

Informata dhe regjistrim

Cité des métiers et de la formation (Qyteti i zanateve dhe i formimit)

6, rue Prévost-Martin
1er étage (kati i parë)
Case postale 192
1211 Genève 4
Tél. 022 388 44 00
Fax 022 388 44 70

www.citedesmetiers.ch/geneve

Orët e pritjes për publikun

E hënë 13:00 - 17:00

E martë– e premte 10:00 -17:00

E enjte 10:00 -19:00

Centres OFPC

OFPC – Centre de Meyrin

2bis, rue de la Prulay
1217 Meyrin
Tél. 022 388 47 01
Fax 022 388 47 00
E hënë – e premte 13:30 – 17:30

OFPC – Centre d’Onex

2, rue des Evaux
1213 Onex
Tél. 022 388 46 81
Fax 022 388 46 80
E hënë – e premte 13:30 – 17:30

E thjeshtë dhe e shpejtë.
Kërkoni në linje nje çek vjetor
formimi:
www.ge.ch/caf

Département de l’instruction publique, de la culture et du sport (Departamenti i edukimit, kulturës dhe sporteve)
Office pour l’orientation, la formation professionnelle et continue (Zyra për orientimin dhe formimin profesional dhe të vazhdueshëm)

6, rue Prévost-Martin • 1205 Genève
Tél. +41 (22) 388 44 00 • ofpc@etat.ge.ch • www.geneve.ch

Papierrecyclé



REPUBLIQUE
ET CANTON
DE GENEVE

REPUBLIKA DHE
KANTONI I GJENEVËS

Të Eukohemi

© OFPC / Août 2015

Dua të ndjek një kurs mbi formimin e të rriturve...

Si të përfitoj nga çeku vjetor për formimin ?

Në një botë në zhvillim të përhershëm, të qenit i kualifikuar, rinovimi dhe perfeksionimi i njohurive është bërë një nevojë e vërtetë.

Ligji mbi formimin e vazhduar i 1 janarit 2011 inkurajon perfeksionimin profesional të të rriturve. Ai parashikon, për të tërë personat që i përgjigjen kriterëve, dhënien e nje çeku prej 750 Franga, deri në tre vjet njëri pas tjetrit. Ky çek lejon të financohen kurse formimi të nevojshme në planin profesional.

Ky dokument ju jep informatat e nevojshme për të përfituar.

Mirëseerdhët në formim.

E thjeshtë dhe e shpejtë.
Kërkoni në linje nje çek vjetor
formimi:
www.ge.ch/caf

Mënyrë përdorimi

Cfarë është çeku vjetor i formimit (CAF) ?

Është një çek vjetor me një vlerë prej 750 CHF maksimum; ai mund t'ju jepet tre vjet rresht ose në një herë sipas tipit të kursit që ju dëshironi të ndiqni. Shuma që mund të financohet në një herë është e disponueshme në sitën tonë Internet kur të seleksiononi kursin e dëshiruar. Kursi i zgjedhur duhet të jetë për një kohëzgjatje minimale prej 40 orësh.

Kush mund të përfitojë?

- A** Personat mbi 18 vjeç që janë taksapagues në kanton prej të paktën një viti në momentin e fillimit të formimit të kërkuar.
- B** Personat mbi 18 vjeç që kanë një leje pune kufitare (frontalier) prej një viti në momentin e fillimit të formimit të kërkuar.
- C** Qytetarët zvicerianë mbi 18 vjeç me banim afër kufirit dhe që punojnë në kanton prej të paktën një viti në momentin e fillimit të formimit të kërkuar.

	Person beqar, i/e ndarë apo i/ e divorcuar	Person i/e martuar (të ardhurat e çiftit)
Kriteret për dhënien e çekut	Fr. 88'340.-	Fr. 132'510.-
	Fr. 95'800.- me 1 fëmijë	Fr. 139'970.- me 1 fëmijë
	Fr. 103'260.- me 2 fëmijë	Fr. 147'430.- me 2 fëmijë
	Fr. 110'720.- me 3 fëmijë	Fr. 154'890.- me 3 fëmijë

Cilat kurse subvencionohen?

Ku mund t'a konsultoj listën e kurseve?

Më shumë se 800 kurse të pranuar, të dhënë nga rreth 70 institute shkollimi në Gjenevë mund të ndiqen me çekun vjetor të formimit. Këto kurse prekin fusha të ndryshme: gjuhë, informatikë, menaxhim dhe administrim, teknikë dhe artizanat, turizëm, hoteleri dhe restorante, shëndet dhe social, art, etj. Vetëm kurset që janë në listë japin të drejtë për çekun vjetor për formim. Listën mund ta konsultoni në internet:

Siti CAF : www.ge.ch/caf

Siti OFPC : www.ge.ch/ofpc/trouver/financer_formation.asp

Siti SBPE : www.ge.ch/bourses/formation

Siti Cité des métiers et de la formation (Qyteti i zanateve dhe i formimit) : www.citedesmetiers/geneve

Ju mund të konsultoni gjithëashtu listën e kurseve në Cité des métiers et de la formation (Qyteti i zanateve dhe i formimit) ose në një nga tre adresat OFPC të kantonit të Gjenevës (shihni faqen e parë). Institutet që japin formacionet e përgatitura vënë gjithëashtu në dispozicion listën e kurseve që lejojnë të përfitoni nga çeku vjetor i formimit.

Si ta bëni kërkesën tuaj ?

1. Merrni kontakt me institutin e formimit për tu siguruar që data e kursit, përmbajtja dhe kostoja e tij i korrespondojnë dëshirave tuaja.
2. Regjistrohuni pranë institutit të formimit për kursin që doni të ndiqni dhe kërkojini që t'ju çojnë me shkrim :
 - Numrin e referencës së kursit të pranuar dhe që jep të drejtë për çekun vjetor të formimit
 - Numrin e institucionit të tyre
3. Mblidhni elementët e mëposhtëm
 - Numrin tuaj të taksapaguesit (gjendet në fletën tuaj për pagimin e taksave)
 - Datën tuaj të mbërritjes në Gjenevë ose, për kufitarët (frontaliers), datën e kontratës së punës.
4. Bëni kërkesën për të marrë çekun me internet në sitin www.ge.ch/caf. Është mënyra më e thjeshtë dhe e shpejtë

Nëqoftëse nuk e njihni përdorimin e internetit, merrni takim në Cité des métiers et de la formation (Qyteti i zanateve dhe i formimit) ose në një nga 3 adresat e OFPC të Gjenevës (shikoni faqen e parë).

Kujdes : kërkesa juaj do të merret në konsideratë vetëm nëqoftëse ajo kryhet përpara fillimit të kurseve.

Si trajtohet kërkesa ?

Kur kërkesa juaj është regjistruar, ajo trajtohet nga SBPE (Shërbimi i bursave dhe i huave për studime).

- Vendimi do t'ju merrrijë me postë.
- Elemente komplementarë mund t'ju kërkohen (në këtë rast, kini kujdes që t'ja dërgoni SBPEs. Mos dërgoni asgjë pa kërkesën e këtij Shërbimi).
- Në rast vendimi pozitiv, çeku do t'ju dërgohet dhe ju duhet t'ja paraqitni institutit të formimit.
- Vetëm SBPE mund t'ju japë informata mbi trajtimin dhe ndjekjen e kërkesës suaj.

Të tërë dokumentat në lidhje me një kërkesë për çekun vjetor të formimit duhet ti drejtohen vetëm në SBPE/CAF, case postale 192, 1211 Genève 4.

Ceku vjetor i formimit nuk mund të mblidhet me një ndihmë të dhënë nga SBPE për të njejtin kurs.

Për personat e regjistruar në papunësi (chômeage), është e rëndësishme të kujtojmë që formimet e ndjekur mbi bazën e një vendimi të OCE janë, në princip, të paguara nga sigurimi mbi papunësinë (assurance chômage). Formimet që ndërmerren me kontributin e çekut vjetor të formimit nuk duhen të ndikojnë negativisht në disponibilitetin për të kërkuar ose okupuar një vend pune. Në rast dyshimi dhe me qëllim që evitohet çdo vështirësi, është e domosdoshme që të kërkohet mendimi i këshillëtarit në personel të OCP.